

AKT- THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJËGJËSI TË
KUFIZUAR
“BIG SKENDERBEG” Sh.p.k.

Midis:

1. Shoqëria **“BIGALB GROUP” shpk.** Person Juridik shqiptar i regjistruar si i tillë pranë Regjistrat Tregëtar në QKR, pajisur me Nipt **L11521002M** dhe seli në *Tiranë, Vaqarr, Fshati Gropaj, Godina Tirana Çash & Carry, kati 2*. Me përfaqësuese Ligjore Znj. Valmira Dedgjoni, atësia Lik, e dtl. 05.12.1975, e lindur në Kamëz dhe banuese në Tiranë, me adresë “A.Vokshi”, Nd.104; H.2, Njësia Administrative Nr.9; Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr. Pers H56205074V lëshuar më datë 23.08.2021.
2. Shoqëria **“B-IDEALGROUP” sh.p.k.** Person Juridik shqiptar i regjistruar si i tillë pranë Regjistrat Tregëtar në QKB, pajisur me Nipt M31722025S dhe seli në *Tiranë. Rr Dervish Hima, Nr pasurie 6/369-N5, Zona Kadastrale 8160, përballë Ambasadës Amerikane*. Me përfaqësues Ligjor Z. Vladimir Lleshaj, i biri i Vlashit, i datëlindjes 08.04.1978, i lindur ne Prosek, Mirëditë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi me nr. Personal H80408150T lëshuar me datë 20.11.2019.
3. **Znj. Donika Jaku**, e dtl. 22.05.1976, lindur Rrushkull, Mirditë dhe banuese në Shkodër, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi me nr. Personal H65522043Q.

Në bazë të legjislacionit shqipëtar kanë vendosur me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, marrëveshjen për themelimin e shoqërisë tregtare private, me përgjegjësi të kufizuar, të emërtuar **“BIG SKENDERBEG ” Sh.p.k.** e cila do të rregullohet në mbështetje të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”; ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Për

regjistrimin e biznesit” i ndryshuar , si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe normave që vijojnë:

Neni 1

Te themelojë një shoqëri tregëtare me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “Big Skenderbeg” Sh.p.k. “Big Skenderbeg” Sh.p.k. është një subjekt juridik Shqiptar, të cilit i lind e drejta të ushtrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Shoqëria “Big Skenderbeg” Sh.p.k. zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj.

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet sipas ligjit.

Neni 3

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë:

- Tregëtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me pakicë si:
- Tregëtim artikuj të ndryshëm industrial;
- Tregëtim artikuj të ndryshëm ushqimore;
- Tregëtim artikuj të ndryshëm bujqësore e blegtorale;
- Tregëtim fruta – perime;
- Tregëtim pije alkolike të ndryshme;
- Tregëtim konfeksione të ndryshme për të rritur dhe fëmijë;
- Tregëtim prodhimesh kozmetike e estetike;
- Tregëtim mallrash të të gjitha llojeve Brenda dhe jashtë vendit;
- Tregëtim automjetesh të cdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjesë këmbimi për to;
- Tregëtim, montim, riparim paisjesh elektro-shtëpiake, elektronike, elektrike, kompjuterike, higjeno-sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati, paisje zyrash etj;
- Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, motelesh, diskotekash, bar-kafe, lojra argëtuese për fëmijë, qendër sportive, qendra pushimi e kurative;

- Tregëtimin e karburanteve të ndryshëm me pakicë, si dhe vajrave lubrifikante, të gazit të lëngshëm për ngrohje, pajisje ngrohëse gazi si dhe mbushjen e bombolave të gazit dhe tregëtimin e tyre me pakicë.
- Tregëtimin e artikujve të ndryshëm kancelarik, libra, revista etj

Neni 4

- Shoqëria "Big Skenderbeg" Sh.p.k. ka selinë e saj në adresën: " Lagj. Skenderbeg, Rr. Adem Jashari, Nr. pasurie 9/747-N1, Zona Kadastrale Nr.8592, rreth rrotullimi i spitalit, Shkoder."

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë "**Big Skenderbeg**" Sh.p.k. do të jetë **12.000.000 (dymbëdhjetë milionë)** lekë dhe është i përbërë nga shuma në të holla e derdhur nga ortakët.

Neni 6

Palët kontraktuese kanë rënë dakort të përcaktojnë kuotën e pjesëmarrjes të secilit ortak si më poshtë:

Emri	Kuota	Përqindja	Kontributi në lekë
BIGALB GROUP	1	51%	6.120.000
B-IDEALGROUP	1	33%	3.960.000
DONIKA JAKU	1	16%	1.920.000

Neni 7

Kohëzgjatja e shoqërisë "Big Skenderbeg" Sh.p.k. do të jetë me afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në cdo kohë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 8

I gjithë kapitali i vënë nga të tre ortakët themelues është tërësisht dhe plotësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm nga ana e tyre.

Neni 9

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregëtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga të dy ortakët. Rritja e kapitalit themelor të shoqërisë nuk është e kufizuar.

Neni 10



Të ardhurat e realizuara nga shoqëria do të ndahen pjesërisht ose totalisht ndërmjet ortakëve sipas kuotave të tyre të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar si dhe nëpërmjet akteve të tjera noteriale apo kontratave të punës që ata do të realizojnë, pasi të jetë lënë një shumë mënjane të paktën sa një e njëzeta e tij e cila destinohet për formimin e fondit rezervë.

Neni 11

Ne kohën e prishjes së shoqërisë ose të përfundimit të afatit, kur nuk ka zgjatje afati kapitali i shoqërisë pasi të hiqen debitë e saj do të ndahet proporcionalisht ndërmjet ortakëve sipas kuotave të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar.

Neni 12

Fitimi i realizuar nga veprimtaria ekonomike e shoqërisë, pas shlyerjes së detyrimeve ligjore dhe ato që kanë lindur me të tretët, është plotësisht i transferueshëm dhe për tu depozituar në një nga Bankat Shqiptare, ose për tu përdorur sipas nevojave të ortakëve të shoqërisë.

Neni 13

Ortakët kanë këto të drejta dhe detyra themelore:

- të derdhin kuotën e kapitalit bazë sikundër është përcaktuar në nenin 6,
- të marrin pjesë në drejtimin e shoqërisë,
- të tërheqin fitimin e realizuar,
- të tërheqin aktivin resultant nga bilanci i likuidimit në rast të pushimit të aktivitetit të shoqërisë,
- të ruajnë sekretin e aktivitetit të shoqërisë,
- të impenjohen për arritjen e objektivave të shoqërisë.

Neni 14

Organet e shoqërisë “Big Skenderbeg” Sh.p.k. janë:


- Asambleja e Ortakëve të shoqërisë
- Administratori i shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë

Administrator i shoqërisë do të jetë Z. Valentin Jaku për një afat 5 vjeçar.

Neni 15

Shoqëria është person juridik shqipëtar dhe do të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike private në bazë të legjislacionit shqipëtar në fuqi dhe veçanërisht ligji 9901 date 14.04.2008 “Për



Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, të K. Civil si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Neni 16

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit, që lidhet midis palëve në mbështetje të ligjit Nr.7961, date 12.07.1995 (KODIT TË PUNËS), si dhe akteve të tjera në zbatim të tij.

Neni 17

Mosmarrëveshjet e mundëshme që mund të lindin gjatë interpretimit apo zbatimit të kësaj kontrate palët do t'i zgjidhin në rrugë miqësore, në të kundërt kompetencat për zgjidhjen e konfliktit i kalon Gjykatës së Rrethit Gjyqësor përkatës.

Neni 18

Për sa nuk përshkruhet në këtë kontratë themelimi do të aplikohen nenet e statutit të shoqërisë dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Neni 19

Ky Akt-themelimi është përpiluar në tre kopje origjinale.

Datë 03 / 03 / 2025

ORTAKËT THEMELUES

Shoq. “Bigalb Group” sh.p.k.

Z. Vullnet Sinaj

Personi besuar

Znj. Valmira Dedgjoni

Shoqëria

B-IDEALGRTOUP sh.p.k

Z. Vladimir Lleshaj

Znj. Donika Jaku

Valmira Dedgjoni


Vladimir Lleshaj


Donika Jaku
